



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2214 Prot

Peshkopi, më 21.062022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.50

Data 16.06.2022

“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër.” “Uniforma dhe veshje të tjera speciale për zjarreffikësen”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Në mungesë dhe porosi

Punonjësja e Sekretariatit të Këshillit

P/Sara Karaj





22/6/2022
23/06/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.577/1 prot.

Peshkopi, më 23.06.2022

Lënda : Per vendimin nr. 50, datë 16.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISË DIBËR

P E S H K O P I

Në mbështetje të ligjit nr.1077/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.50, date 16.06.2022 “Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër “ uniforma dhe veshje të tjera special për zjarrëfiksë”, vendosa :

Miratimin në parim të aktit administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to, veprime që kudoherë janë përgjegjësi direkte administratoro- ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paragesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

Në të njëjtën kohë i tërheqim vëmendjen Strukturës Përgjegjëse , për mos paraqitjen e pasqyrave përkatese, sipas përcaktimit të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr.175, date 9.7.2020 dhe neni 4 të Rregullores “verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 1 shkronja “b”, veprim disa herër i përsëritur për vendimmarrjet me karakter financiar.

P R E F E K T I





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.50 Datë 16/06/2022

“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.51/1 prot. datë 21.01.2022, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 16.06.2022 me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim

VENDOSI:

1. Miratimin e një shrese të zërit të fondit të financimit për shpenzimin e planifikuar “Uniforma dhe veshje të tjera speciale për zjarëfiksën si më poshtë:

2. Të pakësohet:

Gr 0,0 Tit.1110 Kap.1 Art. 602 vlera e mbetur 600,000 lekë për “Blerje uniforma dhe veshje të tjera special për policinë bashkiake”, e planifikuar në buxhet vlera 1,200,000 lekë dhe realizim kontrate 576,000 lekë.

Të shtohet:

Gr 0,0 Tit.3280 Kap.1 Art.602 të shtohet vlera 600,000 lekë për “Uniforma dhe veshje të tjera special për zjarëfiksën” e planifikuar në Buxhet 523,000 lekë dhe të bëhet 1,123,000 lekë.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria MZSH, Sektori I Prokurimeve dhe Sektori I Financës pranë Bashkisë Dibër.

Adresa: Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822937

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetari Këshillit





BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT - VENDIM

Nr. 13 Datë 16/06/2022

“Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022:

Kërkojmë:

I. Miratimin e një shtese të zërit të fondit të financimit për shpenzimin e planifikuar “Uniforma dhe veshje te tjera speciale per zjarriksen” si më poshtë:

II. Të pakësohet :

Gr 0,0 Tit. 1110 Kap. 1 Art. 602 vlera e mbetur 600,000 lekë për “Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale për policinë bashkiake” e planifikuar në buxhet vlera 1,200,000 lekë dhe realizim kontrate 576,000 lekë.

Të shtohet :

Gr 0,0 Tit. 3280 Kap. 1 Art. 602 të shtohet vlera 600,000 lekë për “Uniforma dhe veshje te tjera speciale per zjarriksen” e planifikuar në buxhet 523,000 lekë dhe të bëhet 1,123,000 lekë.

III. Me zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria MZSH, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse sektorit Juridik
Elona Lusha

~~Drejtor Ekonomik~~
Lorenc Cibaku

Përgjegjëse Finance
Mensur Shehi

KRYEQARBI BASHKISË
Këshillim Spahiu




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA SHËRBIMIT MZSH-së



Nr. 1078 Prot

Data: 13/04 2022

MIRATOHEFT



Lënda: Kërkesë për blerje uniforma sherbimi dhe pune per punonjesit e Sherbimit te MZSH-se për vitin 2022.

Drejtuar: Bashkisë Dibër, kryetari Z.Rahim SPAHJU.
:Drejtorise Ekonomike,Zyres se Prokurimeve.

Punonjesit e Sherbimit te MZSH-se Bashkia Dibër, qe nga viti 2002 nuk jane pajisur me asnje lloj uniforme, perjashtuar nje uniforme pune e thjeshte qe eshte bere ne vitin 2018.

Nisur nga gjendja shume e dobet e uniformes se sherbimit te punes, nga fondi i deleguar per MZSH-ne, si dhe shitesa qe u be ne buxhetin e saj per vitin 2023, u planifikuan 1 110 000 leke per blerjen e tyre.

Kerkojme nga Bashkia Dibër te miratohet shumua e mesiperme, pasi ka ndodhur nje gabim dhe nga ana juaj eshte miratuar nje fond prej 511 000 lekesh per blerjen e ketyre uniformave.

Llogaritjet e shumes se kerkuar me sipër janë bere ne baze te preventivit te bere nga ana jone bazuar ne VKM-ne nr.1153, date 24.12.2020, si dhe ofertave te marra nga vendet e prodhimit te uniformave. Kostoja totale e uniformes se nje punonjesi rezulton te jete 44 400 (dyzete e kater mijë e katerqind) leke.

Bashkengjitur kesaj kerkese po vendosim preventivin e uniformave dhe nje kopje te VKM-se nr, 1153 date 24.12.2020.

Drejtor i shërbimit MZSH-së

Komisar Fatos GJOKA



LIDHIJA NR. 1

UNIFORMA E PUNONJËSVE DREJTUES TË NIVELIT TË MESËM, TË IARTË

Nr.	Artikulli	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup	1	3	Blu e errët
	Kostum stofi me përzierje	1	3	Blu e errët
	Xhakete	1	2	Blu e errët
2	Pantallona stofë	2	1	Blu e errët
	Kapele	1	2	E bardhë
	Këmisha me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
	Pulover e trikotuar me jakë "V"	2	2	Blu e errët
3	Bluzë pambuku me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
4	Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	2	1	E bardhë
6	Pantallona vere	2	1	Blu e errët
7	Fund veror	2	1	Blu e errët
8	Rrip pantallonash	1	2	E zezë
9	Këpuce vetore	1	1	E zezë
	Këpuce dimërore	1	1	E zezë
	Këpuce me qafa	1	1	E zezë
10	Çorape	5	1	Blu e errët
11	Kravarë	1	1	Blu e errët
12	Kostum doku siërvijë	1	2	Blu e errët
13	Grada të mëdha spaletit; të vogla gjoksi.	2	3	Sipas specifikimeve të VKM-së nr. 895, datë 21.12.2016, "për kriteret e ecursë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

.....
Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr. tel. & fax. 00355 218 229 37
.....

Relacion shpjegues për miratimin "Për një ndryshim në zërin e shpenzimeve operative të planifikuar për vitin 2022, Bashkia Dibër"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronja k, "miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik" si dhe duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, pranë bashkisë Dibër është paraqitur kërkesa nr.1078 prot. datë 08.04.2022, për një shtesë fondi në blerjen e uniformave të shërbimit të MZSH-së për vitin 2022. Miratimin e një shtesë të zërit të fondit të financimit për shpenzimin e planifikuar "Uniforma dhe veshje të tjera speciale per zjarfiksen", vlera e mbetur 600,000 lekë për "Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale për policinë bashkiake" e planifikuar në buxhet vlera 1,200,000 lekë dhe realizim kontrate 576,000 lekë dhe të shtohet shtohet vlera 600,000 lekë për "Uniforma dhe veshje te tjera speciale per zjarfiksen" e planifikuar në buxhet 523,000 lekë dhe të bëhet 1,123,000 lekë.

Drejtor Ekonomik

Lorenc Diba